

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Gjakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 01/01-46547
Data/Datum 20.12.2019

Gjakovë-Djakovica-Gjakova

KOMUNA E GJAKOVËS / OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2019

Datë: 18.12.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 7.1 të Ligjit nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2019 pas diskutimit lidhur me pikën e 4 të rendit të ditës: Propozim-Vendim për ngritjen e Lapidarit të Dëshmorëve të Brigadës së UÇK-së "137 Gjakova", e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Caktohet lokacioni për ngritjen e Lapidarit të Dëshmorëve të Kombit të rënë në Brigadën e UÇK-së "137 Gjakova" .
2. Lokacioni ku do të ngritet Lapidari është i evidentuar në pjesët e ngastrave kadastrale P-70705028-04317-2, Z.K Gjakovë jashtë qytet, dhe ngastrën kadastrale P-70705028-04317-3, Z.K Gjakovë jashtë Qytet, në pronësi të Komunës së Gjakovës .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Anton Shala